

KESH

ENERGJIA E SHQIPËRISË

**“DOKUMENT PËR UNIFIKIMIN E
KLASIFIKIMIT**

**TË PAGAVE DHE SHITESAVE ME
KARAKTER TË PËRHERSHËM TË
PUNONJËSVE TË SHOQËRISË KESH
SH.A. ”**

Tiranë, Nëntor 2024

I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME.

Në fushën e veprimt të këtij vendimi përfshihen punëmarrësit e Aparatit Qëndror dhe të Njërive të Prodhimit.

II. REFERENCA DHE KONSIDERATA LIGJORE.

- Ligji nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare";
- Ligji nr. 7961, datë 12.7.1995 "Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë", ndryshuar. (Për referim të pagës dhe shtesave mbi pagë dhe konceptit të të drejtës së fituar: ku paga si element thelbësor i kontratës së punës, kur ajo përfitohet për një kohë të gjatë (mbi 3 vite), nuk mund të cënohet);
- Statuti i shoqërisë KESH sh.a;
- VKM nr. 142, datë 12.3.2014 "Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të Punës në Institucionet e Administratës Shtetërore dhe Institucionet e Pavarura". (Për analogji mbi grupimin e pozicioneve të ngjashme të punës sipas klasifikimit të profesioneve, përshkrimit të përgjithshëm të tyre dhe kërkesave minimale të punësimit në këto pozicione pune);
- Vendimi nr.18, datë 01.12.2023 "Për një ndryshim në urdhërin nr.9, datë 17.10.2019 "Për miratimin e dokumentit të unifikuar të klasifikimit të punonjësve të KESH sh.a".

III. QËLLIMI.

Ky dokument klasifikon pagat dhe shtesat me karakter të përhershëm të të punësuarve në shoqërinë KESH sh.a. me qëllim:

- Grupimin dhe rikategorizimin e niveleve të pagave si dhe vendosjen e përcaktimit të kriterëve për lëvizjen nga njëra klasë page tek tjetra për të njëjtën kategori page (kur kjo është e mundur);
- Një shpërndarje të drejtë të kategorive dhe klasave sipas përgjegjësisë, rëndësisë, lirisë së vendimarrjes, vështirësisë, rrezikshmërisë të kryerjes së detyrave dhe duke krijuar një sistem pagash, trajtimeve të tjera financiare dhe përfitimesh, që mund t'i përgjigjet nevojës për të përmbushur prioritetet;
- Normimin e kalimit nga një nivel klasifikimi në tjetrin;
- Sigurimin e një procesi të drejtë dhe transparent për përcaktimin e pagave që do të ndihmojë në tërheqjen dhe mbajtjen e punonjësve të kualifikuar në Sektorin Energjistik, duke kontribuar në zhvillimin e qëndrueshëm;
- Plotësimin e mungesave të Burimeve Njerezore me arsim të mesëm profesional dhe Disiplina Teknike kryesisht lidhur me Inxhinierinë në profilet elektrike, Mekanike, Hidro dhe Ndërtim apo IT, në Aparatin Qëndror dhe akoma më theksuar në Njësitë Prodhuese HEC Koman, Hec Fierzë dhe HEC Vau i Dejës;
- Minimizimin e largimeve të menjëhershme të stafit me profil teknik në Njësitë Prodhuese për faktorë të jashtëm si emigrimi apo punësimi në kompani të tjera të sektorit energjistik me paga më të larta nëpërmjet përmirësimit dhe rritjes së nivelit të pagave.

IV. ELEMENTË PËRBËRËS TË PAGËS BRUTO NË APARAT QËNDROR.

Në shoqërinë "KESH" SHA, paga llogaritet si pagë mujore për pozicion pune. Paga mujore përfshin pagën bazë si dhe shtesat me karakter të përhershëm nga të cilat zbritet tatimi mbi të ardhurat dhe kontributi i sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore sipas kufirit të miratuar me ligj.

1. Paga bazë për pozicion në Aparat Qëndror.
2. Shtesa për vjetërsi në punë në Aparat Qëndror.
3. Shtesë mbi pagë për natyrë të veçantë pune në Aparat Qëndror.
4. Shtesë page për orët jashtë kohës normale të punës në Aparat Qëndror.
5. Shtesë page për turne të dyta, të treta (Turni II+III) në Aparat Qëndror.

IV.1. Kategoritë, Klasat e pagave për pozicione pune në Aparat Qëndror.

Kategoria		Funkstori	Klasa e pagave
E Lartë Drejtuese	I	Administrator	I - a ✓
		Koordinatori i Rrjetit Antikorrupsion	I - a/1
		ZV/Administrator	I - a/2
		Drejtor Divizioni me Funksion Teknik	I - b
		Drejtor Divizioni me Funksion Administrativ	I - b/1
		Drejtuesit e Njesive Prodhuese	I - c
E Meme Drejtuese	II	Drejtor Departamenti me Funksion Teknik	II - a
		Drejtor i NJMP me Financim te Huaj	II - a/1
		Drejtor i Kabinetit	II - b
		Drejtor i Auditit të Brendshëm	II - b
		Drejtor Departamenti me Funksion Administrativ	II - b
		Keshilltar ne kabinet	II - b/1
E Ulët Drejtuese	III	Shef Sektori me Funksion Teknik	III - a
		Shef Sektori me Funksion Administrativ	III - b
Ekzekutive	IV	Specialist i Nivelit të Parë	IV - a
		Specialist i Nivelit të Dytë	IV - b
		Specialist i Nivelit të Tretë	IV - c
		Specialist i Nivelit të Katert/ Asistente	IV - d
		Administratori/ Asistente Zv-Administratori	
Punonjës mbështetës	V	Asistent sherbim sekretarie/ Punonjese Receptionsi/ magazinier specialist mirembajtje, shofer administratori	V - a
		Shofer ne Aparatin qendror	V - b
		Punonjes sanitare / punonjes mirembajtje	V - c

Përshkrim i përgjithshëm për çdo kategori.

Sqarime mbi Kategorinë e Lartë Drejtuese I:

Është kategoria më e lartë e menaxhimit të shoqërisë, që ka përgjegjësinë për formulimin e politikave dhe këshillimin rreth tyre; që përcakton objektivat dhe formulon programet, standardet dhe procedurat përkatëse për zbatim; që siguron përdorimin eficient të burimeve materiale, njerëzore dhe financiare të nevojshme për realizimin e programeve dhe arritjen e objektivave; që planifikon dhe drejton veprimtarinë e përditshme administrative të shoqërisë.

Sqarime mbi Kategorinë e Mesme Drejtuese II:

Kjo kategori është përgjegjëse për menaxhimin e një nënfushe të veçantë veprimtarie brenda fushës së veprimtarisë së shoqërisë; planifikon, drejton dhe koordinon veprimtarinë e njësive organizative në përputhje me programin dhe politikat e miratuara; ka përgjegjësi të qartë për zbatimin e politikave ekzistuese; identifikon nevojat e zhvillimit të politikave dhe rekomandon komponentë të planifikimit strategjik brenda fushës së veprimtarisë nën përgjegjësi.

Sqarime mbi Kategorinë e Ulët Drejtuese III:

Kjo kategori është përgjegjëse për mbikëqyrjen dhe koordinimin e veprimtarisë administrative të shoqërisë; udhëzon, këshillon dhe ndjek nga afër zbatimin e detyrave të stafit nën varësi; analizon dhe zgjidh probleme, ka liri gjykimi brenda kuadrit të politikave dhe në përputhje me procedurat, bën interpretimin e politikave duke përdorur njohuri të thella profesionale; jep kontribut në procesin e vendimmarrjes të nivelit të mesëm drejtues, sipas fushës së ekspertizës, nëpërmjet sigurimit të të dhënave të detajuara dhe analizave, të cilat mbështesin linjën e propozuar të veprimit.

Sqarime mbi Kategorinë Ekzekutive IV:

Kjo kategori zbaton detyrat në përputhje me udhëzimet dhe ofron mbështetje burokratike, ose tjetër mbështetje bazë pa u përfshirë në përgjegjësi mbikëqyrëse. Veprimtaria e përditshme kërkon njohuri të përgjithshme administrative dhe/ose njohuri të posaçme të një profesioni të caktuar.

Emërtesa e pozicionit: Specialist i nivelit të parë, klasa IV – a.

Kjo klasë përfshin specialistë të cilët kryejnë detyra që kërkojnë njohuri të thella profesionale në fushë; puna kryhet brenda udhëzimeve të përgjithshme lidhur me objektivat dhe afatet e përfundimit të detyrave; detyrat/projektet realizohen në përputhje me politikat e shoqërisë, me standardet administrative dhe procedurat teknike, si dhe duke mbajtur parasysh praktikat profesionale; përmbushja e detyrave kërkon aftësi analitike dhe planifikim të pavarur; nisur nga detyrat e pozicionit të punës, specialistët e këtij niveli identifikojnë mundësitë për përmirësimin e mëtejshëm të procedurave dhe teknikave; diskutojnë rezultatet e punës me eprorin dhe i referohen atij vetëm në rastet e problematikave/çështjeve jo të zakonshme. Eprori kontrollon punën vetëm përse i takon rezultatit dhe zakonisht nuk ndërhyr lidhur me përmbajtjen e saj.

Zgjidhja e problemeve (kompleksiteti & pasoja): Zakonisht e standardizuar dhe deri diku komplekse, problemet e hasura kërkojnë zgjidhje brenda politikave, parimeve dhe objektivave të përcaktuara për funksionin përkatës; zgjidhjet e dhëna ndikojnë në punën e kolegëve dhe të njësisë organizative përkatëse.

Vendimmarrja (lloji & liria e veprimit): është e shpeshtë dhe e vazhdueshme, por brenda një tërësie standardesh administrative dhe/ose procedurash teknike; detyrat/projektet e caktuara kërkojnë analizë dhe planifikim; vendimmarrja lidhet dhe me identifikimin e alternativave për të përmirësuar procedurat dhe teknikat.

Mjedisi menaxherial (marrëdhënia e menaxhimit & fokusi i veprimtarisë): puna e specialistit të këtij niveli ndikon në rezultatet e të gjithë sektorit dhe mbikëqyrja realizohet nga përgjegjësi i sektorit.

Njohuri dhe aftësi: njohuri të gjera të fushës, të metodave kërkimore, që ndihmojnë në përgatitjen e raporteve bazike ose analitike; aftësi për të integruar informacionin me politikat institucionale, aftësi për të identifikuar dhe qartësuar çështje, për të dhënë mendime alternative të mbështetura në përvojën profesionale, aftësi për të vlerësuar opsione politikash dhe për të parashikuar pasojat nga përzgjedhja e tyre.

Emërtesa e pozicionit: Specialist i nivelit të dytë, klasa IV – b.

Kjo klasë përfshin specialistë të cilët kryejnë detyra për realizimin e të cilave nevojiten njohuri të plota të një fushe të caktuar; përmbushja e detyrave realizohet duke ndjekur udhëzimet dhe praktikën institucionale të shoqërisë; kërkohet që gjatë punës të zhvillohet një analizë e kujdesshme

e informacionit faktik; mund të përshtatin procedurat, teknikat, mjetet materiale dhe /ose pajisjet me nevojat e fushës së veprimtarisë; mund të kryejë punë të cilat nuk janë rutinë; zgjidh çështje brenda fushës së përgjegjësisë.

Zgjidhja e problemeve (kompleksiteti & pasoja): zakonisht e standardizuar, problemet e hasura kërkojnë zgjidhje brenda objektivave të përcaktuara për funksionin përkatës; zgjidhjet e dhëna ndikojnë në punën e kolegëve dhe të njësisë organizative përkatëse.

Vendimmarrja (lloji & liria e veprimit): është rutinë, brenda standardeve administrative dhe/ose procedurave teknike.

Mjedisi menaxherial (marrëdhënia e menaxhimit & fokusi i veprimtarisë): puna e specialistit të këtij niveli ndikon në rezultatet e të gjithë sektorit dhe mbikëqyrja realizohet nga përgjegjësi i sektorit.

Kërkesa të posaçme

Njohuri dhe aftësi: Dije të përgjithshme të parimeve, koncepteve, metodave dhe teknikave të një profesioni, të mjaftueshme për të realizuar detyrat e pozicionit. Aftësi për të përzgjedhur informacionin e nevojshëm ose materiale referuese të nevojshme, për të realizuar detyra që lidhen me fushën përkatëse të njohurive; aftësi shumë të mira organizative.

Emërtesa e pozicionit: Specialist i nivelit të tretë, klasa IV – c.

Kjo klasë përfshin specialistë të cilët kryejnë detyra rutinë brenda një funksioni; kryejnë detyra për përmbushjen e të cilave nuk kërkohet përvojë e mëparshme pune; për realizimin e detyrave përdoren koncepte bazë nga fusha përkatëse e arsimimit; pozicioni kërkon që t'u jepet zgjidhje problemeve të thjeshta; detyrat në këto pozicione kryhen në përputhje me udhëzimet/procedurat të cilat janë të detajuara; puna kryhet nën mbikëqyrjen shumë të afërt të eprorit, i cili jep udhëzime verbale ose me shkrim; specialisti i këtij niveli konsultohet me eprorin për çdo paqartësi apo vështirësi të hasur gjatë punës.

Zgjidhja e problemeve (kompleksiteti & pasoja): zakonisht e standardizuar, problemet e hasura kërkojnë zgjidhje brenda objektivave të përcaktuara për funksionin përkatës; zgjidhjet e dhëna ndikojnë në punën e kolegëve dhe të njësisë organizative përkatëse.

Vendimmarrja (lloji & liria e veprimit): është rutinë, brenda udhëzimeve dhe/ose procedurave.

Mjedisi menaxherial (marrëdhënia e menaxhimit & fokusi i veprimtarisë): puna e specialistit të këtij niveli ndikon në rezultatet e të gjithë sektorit dhe mbikëqyrja realizohet nga përgjegjësi i sektorit.

Njohuri dhe aftësi: Dije të përgjithshme të parimeve, koncepteve, metodave dhe teknikave të një profesioni, të mjaftueshme për të realizuar detyrat e pozicionit. Aftësi për të përzgjedhur informacionin e nevojshëm ose materiale referuese të nevojshme, për të realizuar detyra që lidhen me fushën përkatëse të njohurive; aftësi shumë të mira organizative.

Emërtesa e pozicionit: Specialist i nivelit të katërt, klasa IV – d.

Kjo klasë përfshin specialistë të cilët realizojnë detyra që caktohen nga eprori ose një specialist i vjetër me përvojë së bashku me udhëzime të qarta, të detajuara dhe specifike përsa i takon formës, metodologjisë, burimeve dhe përparësisë. Puna e kryer mund të kontrollohet lidhur me saktësinë, formën, organizimin, metodologjinë, zbatimin në afat dhe procedurat përkatëse.

Zgjidhja e problemeve (kompleksiteti & pasoja): problemet e hasura kërkojnë zgjidhje brenda procedurave të përcaktuara; zgjidhjet e dhëna ndikojnë në punën e kolegëve dhe të njësisë

organizative përkatëse.

Vendimmarrja (lloji & liria e veprimit): është rutinë, brenda procedurave të detajuara.

Mjedisi menaxherial (marrëdhënia e menaxhimit & fokusi i veprimtarisë): puna e specialistit të këtij niveli ndikon në rezultatet e të gjithë sektorit dhe fokusohet në një kufizim të caktuar; mbikëqyrja realizohet nga eprori ose nga një specialist me përvojë.

Kërkesa të posaçme

Arsimi: Bachelor. Diplomat, të cilat janë marrë jashtë vendit, duhet të jenë njohur paraprakisht pranë institucionit përgjegjës për njehsimin e diplomave, sipas legjislacionit në fuqi.

Njohuri dhe aftësi: Dije të përgjithshme, të mjaftueshme për të realizuar detyrat e pozicionit. Aftësi për të përzgjedhur informacionin e nevojshëm ose materiale referuese të nevojshme për të realizuar detyra që lidhen me pozicionin. Aftësi për të plotësuar praktikatat e punës në afatin e kërkuar.

Sqarime mbi Kategorinë V, Punonjës mbështetës:

Kjo kategori përfshin asistent shërbim sekretarie/ punonjëse recepsioni/ magazinier specialist mirëmbajtje, shofer administratori, Shofer në Aparatin qendror, Punonjës sanitare/ punonjës mirëmbajtje.

V. Përcaktimi i kriterëve për lëvizjen nga njëra klasë page tek tjetra për të njëjtën kategori page dhe rekrutimet e reja në Aparatin Qendror.

Kriteri i lëvizjes nga njëra klasë në tjetrën, për Kategorinë Ekzekutive, bëhet në bazë të vlerësimit dhe plotësimit të njëkohshëm të kushteve si më poshtë vijon:

- a. vjetërsi pune në shoqëri, (lëvizja nga njëra kategori në tjetrën sipas vite pune në profesion, normohet sipas intervaleve 0 deri në 3 vite, 3 deri në 5 vite dhe mbi 5 vite pune në profesion),
- b. vlerësimit të fundit të punës “mirë” ose “shumë mirë”
- c. të mos ketë masë disiplinore në fuqi.

Mënyra e punësimit:

Punësimi në Kesh sh.a. bëhet në referencë të kriterëve arsimore bashkëlidhur këtij vendimi, akteve ligjore në fuqi dhe politikës së Burimeve Njerëzore në Kesh sh.a.

I njëjti kriter vjetërsie pune në profesion do të shërbejë dhe për pozicionimin e punonjësve që do të rekrutohen në nivelet respektive, ku konkretisht, punonjësi i rekrutuar do të kategorizohet në klasën përkatëse sipas vjetërsisë së punës në profesion, si më poshtë:

- a. 0 deri në 3 vite, specialist i nivelit të tretë, klasa IV-c
- b. 3 deri në 5 vite, specialist i nivelit të dytë, klasa IV-b
- c. mbi 5 vite pune në profesion, specialist i nivelit të parë, klasa IV-a.

Rekrutimet me Diploma të programeve të studimit “Bachelor”, do të kategorizohen si specialist të nivelit të katërt, klasa IV-d.

VIII. Elementë përbërës të pagës bruto në Njësitë Prodhuese.

Në Shoqërinë "KESH" SHA, paga llogaritet si pagë mujore për pozicion pune. Paga mujore përfshin pagën bazë si dhe shtesat me karakter të përhershëm nga të cilat zbritet tatimi mbi të ardhurat dhe kontributi i sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore sipas kufirit të miratuar me ligj.

1. Paga bazë për pozicion në Njësitë e Prodhimit
2. Shtesa për vjetërsi në punë në Njësitë e Prodhimit.
3. Shtesë mbi pagë për natyrë të veçantë pune në Njësitë e Prodhimit
4. Shtesë page për largësi nga qendra e punës në Njësitë e Prodhimit.
5. Shtesë page për orët jashtë kohës normale të punës në Njësitë e Prodhimit.
6. Shtesë page për turne të dyta, të treta (Turni II+III) në Njësitë e Prodhimit.

Kategoritë, Klasat e pagave për pozicione pune në Njësitë Prodhuese.

Nr. rendor	Emertimi i pozicionit	Klasa e propozuar e pagës
1	Shofer (me arsim te mesem te detyrueshem)	I
	Punonjes sanitare (me arsim te mesem te detyrueshem)	
	Punetor me arsim te mesem te detyrueshem	
2	Shofer Titullari	II
	Elektracist ndihmes	
	Ndihmes turbinist	
	Droselist vepra e marrjes mekanik	
	Droselist vepra e marrjes elektrik	
	Pompist Kompresorist	
	Asistent teknik	
	Pompist Galeria e Diges	
3	Asistent/ Sekretare	III
	Protokollist-Arshivist	
	Magazinier	
	Remontier/Remontier Primar ose Sekondar	
	Turbinist	
	Operator Teknik	
	Drejtues per mjetet teknologjike	
	Laborant vajrash	
	Teknik	
	Baterist	
	Articier	
4	Elektracist kryesor ne salle komandimi	IV
	Turbinist kryesor	
	Pizometrist	
	Saldator	
5	Pergjegjes grupi	V
	Polumbar	
6	Dispecer rajonal (me arsim te mesem)	VI
	Punonjes me arsim te larte - Cikl I Pare (Bachelor)	
7	Asistent/ Sekretare	VII

Nr. rendor	Emertimi i pozicionit	Klasa e propozuar e pages
	Protokollist - Arshivist	
	Jurist	
	Specialist personeli	
	Specialist sherbimesh	
	Financier	
	Ekonomist	
	Infermieri	
8	Inxhinier Primar	VIII
	Inxhinier I Mbrojtjes Rele dhe Komandimit	
	Inxhinier I Automatikes dhe Rregullimit	
	Inxhinier I Kontrollit dhe Monitorimit	
	Inxhinier Remonti	
	Specialist Mirembajtje per Punet Civile	
	Specialist Kimist	
	Specialist IT	
	Punonjes me arsim te larte - Cikl I Dyte (Master I shkencave ose Master Profesional)	
9	Jurist	IX
	Specialist personeli	
	Specialist sherbimesh	
	Financier	
	Ekonomist	
	Infermieri	
10	Inxhinier Primar	X
	Inxhinier I Mbrojtjes Rele dhe Komandimit	
	Inxhinier I Automatikes dhe Rregullimit	
	Inxhinier I Kontrollit dhe Monitorimit	
	Inxhinier Remonti	
	Specialist I Siguris Teknike, MKZ dhe Shendetit ne Pune	
	Specialist Mirembajtje per Punet Civile	
	Specialist Kimist	
	Specialist IT	
	Mjeku I punes	
	Punonjes me arsim te larte - Cikl I Dyte (Master I shkencave ose Master Profesional)	
11	Shef I Sektorit te sherbimeve dhe personelit	XI
	Shef I Sektorit te mirembajtjes	
	Shef I Sektorit te shfrytezimit	
12	Shef I Sektorit Teknik	XII
	Shef I Sektorit Ekonomik	
13	Pergjegjes Reparti	XIII
14	Dispecer rajonal	XIV

Përshkrim i përgjithshëm për çdo klasë në Njësitë Prodhuese:

Sqarime mbi klasën e I:

Në këtë klasë përfshihen personel me arsim të mesëm që kryejnë punë të specializuar teknike me dorë, që kërkon një kompetencë të fituar nga një eksperiencë pune praktike. Në këtë kategori përfshihet personel i mesëm ose i detyrueshëm në njësitë prodhuese, të cilët kryejnë punë të caktuara siç janë sanitarë, mirëmbajtës etj.

Sqarime mbi klasën e II:

Në këtë kategori përfshihen personel me arsim të mesëm që kryejnë detyra specifike të caktuara në njësitë prodhuese, që kërkon një kompetencë të fituar nga një eksperiencë pune praktike, në fusha dhe profesione të ndryshme sipas specifikave të sektorit apo repartit ku punojnë, por që kanë një përmbajtje apo eksperiencë profesionale më të gjerë.

Sqarime mbi klasën e III:

Në këtë kategori përfshihen personel me arsim të mesëm që kryejnë detyra specifike të caktuara në njësitë prodhuese, në fusha dhe profesione të ndryshme sipas specifikave të sektorit apo repartit ku punojnë, por që kanë një përmbajtje (mbikqyrje dhe/ose kordinim punonjësish) apo eksperiencë profesionale më të gjerë/ Punonjësme arsim të lartë (cikli i parë i studimeve), ose të mesëm të cilët merren me punë të një aspekti të caktuar administrative ose Teknik në njësitë prodhuese. Puna e tyre konsiston në zbatimin e detyrave të ngarkuara nga eprorët dhe përfshin personel me detyra specifike dhe përgjegjësi konkrete për fushën e veprimtarisë ku punojnë por që kanë një eksperiencë më të vogël pune.

Sqarime mbi klasën e IV:

Në këtë kategori përfshihen personel me arsim të mesëm që kryejnë detyra specifike të caktuara në njësitë prodhuese në fusha dhe profesione të ndryshme sipas specifikave të sektorit apo repartit ku punojnë, por që kanë një përmbajtje (mbikqyrje dhe/ose kordinim punonjësish) apo eksperiencë profesionale më të gjerë.

Sqarime mbi klasën e V:

Në këtë kategori përfshihen personel me arsim të lartë (cikël i parë i studimeve) ose me arsim të mesëm të cilët merren me punë të një aspekti të caktuar administrativ ose teknik. Puna e tyre konsiston në zbatimin e detyrave të ngarkuara nga eprorët dhe përfshin personel me detyra specifike dhe përgjegjësi konkrete për fushën e veprimtarisë ku punojnë.

Sqarime mbi klasën e VI:

Kjo kategori përfshin punonjës në njësitë prodhuese të cilët kryejnë detyra rutinë brenda një funksioni; kryejnë detyra për përmbushjen e të cilave mund të mos kërkohej përvojë e mëparëshme pune; për realizimin e detyrave përdoren koncepte bazë nga fusha përkatëse e arsimimit; detyrat në këto pozicione kryhen në përputhje me udhëzimet/procedurat. Kjo kategori përfshin edhe personel që ka një numër punonjësish nën varësi në njësinë e prodhimit.

Sqarime mbi klasën e VII:

Në këtë kategori përfshihen punonjës me arsim të lartë (cikël i parë i studimeve) ose të mesëm të cilët merren me punë të një aspekti të caktuar administrativ ose teknik në njësitë prodhuese.

Puna e tyre konsiston në zbatimin e detyrave të ngarkuara nga eprorët dhe përfshin personel me detyra specifike dhe përgjegjësi konkrete për fushën e veprimtarisë ku punojnë.

Sqarime mbi klasën e VIII:

Në këtë kategori përfshihen punonjës me arsim të lartë (cikël i parë i studimeve) ose të mesëm të cilët merren me punë të një aspekte teknik në njësitë prodhuese. Puna e tyre konsiston në zbatimin e detyrave të ngarkuara nga eprorët dhe përfshin personel me detyra specifike dhe përgjegjësi konkrete për fushën e veprimtarisë ku punojnë si inxhinierë, specialistë të fushave të ndryshme teknike.

Sqarime mbi klasën e IX:

Kjo kategori përfshin punonjës në njësitë prodhuese të cilët kryejnë detyra rutinë brenda një funksioni; kryejnë detyra për përmbytjen e të cilave mund të mos kërkohet përvojë e mëparëshme pune; për realizimin e detyrave përdoren koncepte bazë nga fusha përkatëse e arsimimit; detyrat në këto pozicione kryhen në përputhje me udhëzimet/procedurat. Kjo kategori përfshin edhe personel që ka një numër punonjësish nën varësi në njësinë e prodhimit.

Sqarime mbi klasën e X:

Në këtë kategori përfshihen punonjës me arsim të lartë të cilët merren me punë të një aspekti të caktuar administrativ ose teknik në njësitë prodhuese. Puna e tyre konsiston në zbatimin e detyrave të ngarkuara nga eprorët dhe përfshin personel me detyra specifike dhe përgjegjësi konkrete për fushën e veprimtarisë ku punojnë.

Sqarime mbi klasën e XI:

Personeli i kësaj kategorie është përgjegjës për menaxhimin e një fushe të caktuar të veprimtarisë së institucionit; planifikon, drejton, kordinon veprimtarinë në fushën përkatëse në përputhje me programin dhe politikën e miratuara. Ka përgjegjësi të qartë për zbatimin e politikave ekzistuese; identifikon nevojat e zhvillimit të politikave dhe rekomandon komponentë të planifikimit strategjik brenda fushës së veprimtarisë nën përgjegjësisë. Ky personel është përgjegjës për mbikqyrjen dhe kordinimin e veprimtarisë administrative të sektorit përkatës: udhëzon, këshillon dhe ndjek nga afër detyrat e stafit nën varësi, analizon dhe zgjidh probleme, ka liri gjykimi brenda kuadrit të politikave dhe në përputhje me procedurat, bën interpretimin e politikave duke përdorur njohuri të thella profesionale; jep kontribut në procesin e vendimmarrjes sipas fushës së eksperiencës, nëpërmjet sigurimit të të dhënave të detajuara dhe analizave, të cilat mbështesin linjën e poropozuar të veprimt.

Sqarime mbi klasën e XII:

Personeli i kësaj kategorie është përgjegjës për menaxhimin e një fushe të caktuar të veprimtarisë së institucionit; planifikon, drejton, kordinon veprimtarinë në fushën përkatëse në përputhje me programin dhe politikën e miratuara. Ka përgjegjësi të qartë për zbatimin e politikave ekzistuese; identifikon nevojat e zhvillimit të politikave dhe rekomandon komponentë të planifikimit strategjik brenda fushës së veprimtarisë nën përgjegjësisë. Ky personel është përgjegjës për mbikqyrjen dhe kordinimin e veprimtarisë teknike të sektorit përkatës: udhëzon, këshillon dhe ndjek nga afër detyrat e stafit nën varësi, analizon dhe zgjidh probleme, ka liri gjykimi brenda kuadrit të politikave dhe në përputhje me procedurat, bën interpretimin e politikave duke përdorur njohuri të thella profesionale; jep kontribut në procesin e vendimmarrjes sipas fushës së eksperiencës, nëpërmjet sigurimit të të dhënave të detajuara dhe analizave, të cilat mbështesin linjën e poropozuar të veprimt.

Sqarime mbi klasën e XIII:

Kjo kategori përfshin personelin që zbaton detyrat në përputhje me udhëzimet dhe ofron mbështetje burokratike, ose tjetër mbështetje bazë pa u përfshirë në përgjegjësi mbikqyrëse. Kjo kategori përfshin personel të cilët kryejnë detyra, për realizimin e të cilave nevojiten njohuri të plota të një fushe të caktuar; përmbushja e detyrave realizohet duke ndjekur udhëzimet dhe praktikën institucionale; kërkohet që gjatë punës të zhvillohet një analizë e kujdesshme e informacinit faktik; mund të kryejë punë të cilat nuk janë rutinë; zgjidh çështje brenda fushës së përgjegjësisë.

Sqarime mbi klasën e XIV:

Në këtë kategori përfshihen punonjës me arsim të lartë të cilët merren me punë të një aspekti të caktuar administrativ ose teknik në njësitë prodhuese. Puna e tyre konsiston në zbatimin e detyrave të ngarkuara nga eprorët dhe përfshin personel me detyra specifike dhe përgjegjësi konkrete për fushën e veprimtarisë ku punojnë.

IX. Përcaktimi i kritereve për lëvizjen nga njëra klasë page tek tjetra për të njëjtën kategori dhe rekrutimet e reja në Njësitë Prodhuese.

Kriteri i lëvizjes nga një nivel në tjetrin brenda klasës përkatëse, bëhet në bazë të vlerësimit dhe plotësimit të njëkohshëm të kushteve si më poshtë vijon:

- a. vjetërsi pune në shoqëri, (lëvizja nga njëra kategori në tjetrën sipas vite pune në profesion, normohet sipas intervaleve 0 deri në 3 vite, 3 deri në 5 vite dhe mbi 5 vite pune në profesion),
- b. vlerësimit të fundit të punës “mirë” ose “shumë mirë”
- c. të mos ketë masë disiplinore në fuqi.

Mënyra e punësimit:

Punësimi në Njësitë Prodhuese të Kesh sh.a. bëhet në referencë të kritereve arsimore bashkëlidhur këtij vendimi, akteve ligjore në fuqi dhe politikës së Burimeve Njerëzore në Kesh sh.a.

I njëjti kriter vjetërsie pune në profesion do të shërbejë dhe për pozicionimin e punonjësve që do të rekrutohen në nivelet respektive, ku konkretisht, punonjësi i rekrutuar do të kategorizohet në nivelet e klasës përkatëse sipas vjetërsisë së punës në profesion, si më poshtë:

- a. 0 deri në 3 vite, nivelit të parë të klasës ku bën pjesë.
- b. 3 deri në 5 vite, nivelit të dytë të klasës ku bën pjesë.
- c. mbi 5 vite pune në profesion, nivelit të tretë të klasës ku bën pjesë.

Për nevojat e Korporatës në zhvillim, rritje dhe adaptim ndaj teknologjisë së re si dhe përdorimin sa më efikas të Burimeve Njerëzore lind nevoja e ndërmarrjes së akteve të ndryshimit të pozicioneve.

Ndryshim pozicioni janë lëvizjet e stafit brenda së njëjtës klasë apo dhe klasave të ndryshme sipas miratimit nga Administratori të kërkesës së Drejtorit të Njesisë Prodhuese duke respektuar në mënyrë rigoroze kriteret e kualifikimit arsimor që përmban pozicioni i ri i punës.

X. TË PËRGJITHSHME

Duke ndjekur politikat dhe procedurat e përcaktuara në këtë dokument sigurohet që procesi i përgatitjes dhe shpërndarjes së pagave të jetë:

- Transparent, duke respektuar të gjitha standartet ligjore dhe rregulloret e brendshme;
- I drejtë, duke garantuar që çdo punonjës të marrë pagën në përputhje me kontributin e tij dhe kushtet e kontratës.

Niveli (kategoria) i pagës bazë për punëmarrësit në marrëdhënie pune në Aparatin Qendror, përcaktohet nga Administratori i Shoqërisë KESH SHA pas propozimeve të Drejtuesve të Divizioneve respektive duke pasur parasysh kushtet e mëposhtme:

1. Sipas udhëzuesit sa më sipër të pikës IV.1. Kategoritë, Klasat e pagave për pozicione pune në Aparat Qendror, zëri “Përshkrim i përgjithshëm për çdo kategori”.

2. Vlerësimit të përgjithshëm të nivelit arsimor, kualifikimeve, aftësive profesionale, ekperiencës në punë, përvojës administrative, specifikave të vendit të punës etj.

Niveli (Klasa) e pagës bazë për punëmarrësit në marrëdhënie pune në Njësitë e Prodhimit përcaktohet nga Administratori i Shoqërisë KESH sh.a. sipas kriterit të vjetërsisë në punë në KESH sh.a., duke patur parasysh kushtet e mëposhtme:

- 0 deri në 3 vite, nivelit të parë të klasës ku bën pjesë.
- deri në 5 vite, nivelit të dytë të klasës ku bën pjesë.
- mbi 5 vite pune në profesion, nivelit të tretë të klasës ku bën pjesë.

Zbatimi i këtij dokumenti është përgjegjësi e Administratorit të Shoqërisë KESH sha.



Lidhja nr. III.

Shtesa mbi pagë për vjetërsi në punë të punonjësve të Kesh sh.a. (në Aparatin Qëndror dhe në Njësitë Prodhuese)

Korporata Elektroenergjitike KESH Sh.a., në zbatim të prashikimeve të ligjit nr. 7961, datë 12.7.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar dhe Kontratës Kolektive të punës, trajton punëmarrësit e saj me një shtesë mbi pagë për efekt vjetërsie në punë sipas rregullave si më poshtë vijon:

1. Punëmarrësve të KESH sh.a., për çdo vit pune u jepet një shtesë page për vjetërsi në punë në masën e 2 (dy)% , por jo më shumë se 25%.
2. Për llogaritjen e kësaj shtese njihet vjetërsia e përgjithshme në punë e punonjësit.

Për efekt të llogaritjes së shtesës së vjetërsisë, “vite pune” do të konsiderohet vjetërsia e përgjithshme në punë, e dokumentuar në librezën e punës së çdo punonjësi, apo në mungesë të librezës së punës, me çdo dokument tjetër ligjor të lëshuar nga organet kompetente përkatëse, sipas legjislacionit në fuqi, me përjashtim të viteve të sigurimit vullnetar, vetëpunësimit, shërbimit ushtarak të detyrueshëm, viteve të shkollimit në institucionet e arsimit të lartë dhe periudhës së trajtimit me pagesë papunësie.

Lidhja nr. IV.

Tabela e Kritereve/ Kualifikimeve arsimore për pozicionet e punës në Aparatin Qëndror

Pozicioni i Punës	Arsimi i kërkuar për secilin pozicion pune
Administrator	Arsim i Lartë, Cikël i Dytë "Master i Shkencave" në Ekonomi, Drejtësi ose Inxhinieri Elektrike
Zv. Administrator	Arsim i Lartë, Cikël i Dytë "Master i Shkencave" në Ekonomi, Drejtësi ose Inxhinieri Elektrike
Koordinatori i Rrjetit Antikorrupsion	Diplomë Universitare MSC / Sipas parashikimeve të ligjit për Koordinatorin e Rrjetit të Antikorrupsionit
Drejtor Divizioni	Arsim i Lartë, Cikli i Dytë i studimeve "Master i Shkencave"
Drejtor Kabineti	Arsim i Lartë, Cikël i Dytë i studimeve "Master i Shkencave"
Drejtor Divizioni i Operimit dhe Tregtimit	Diplomë Universitare MSC apo MP në Shkencat Ekonomike, Juridike Ose Inxhinieri Elektrike
Drejtor Divizioni i Administrimit	Diplomë Universitare MSC apo MP në Shkencat Ekonomike/Juridike/Inxhinierike/ Shkenca Sociale
Drejtor Divizioni Teknik	Diplomë Universitare MSC në Shkencat Inxhinierike
Drejtor Departamenti në Aparatin Qëndror	Arsim i Lartë, Cikli i dytë i studimeve "Master i Shkencave"
Drejtor Auditit të Brendshëm	Diplomë Universitare MSC / Sipas parashikimeve të ligjit për Auditin e Brendshëm në sektorin publik
Drejtor Njësia e Koordinimit të Projektit Skavica	Diplomë Universitare MSC në Shkencat Inxhinierike ose Ekonomike ose Juridike
Drejtor Departamenti i Marrëdhënieve me Palët e Treta	Diplomë Universitare MSC apo MP në Shkencat Inxhinierike, Inxhinieri Mjedisi ose Shkenca Sociale/ Shkenca Komunikimi
Drejtor Departamenti në Divizion, Drejtor të Njësive Prodhuese	Arsim i Lartë, Cikli i dytë i studimeve "Master i Shkencave"
Drejtor Departamenti i Transaksioneve Energjitike	Diplomë Universitare MSC apo MP në Shkencat Inxhinierike/ Ekonomike /Juridike
Drejtor Departamenti i Operacioneve të Prodhimit	Diplomë Universitare MSC në Shkencat Inxhinierike
Drejtor Departamenti Juridik	Diplomë Universitare MSC në Shkencat Juridike
Drejtor Departamenti Ekonomik	Diplomë Universitare MSC në Shkencat Ekonomike (Profili Financë ose Kontabilitet)
Drejtor Departamenti i Prokurimeve	Diplomë Universitare MSC në Shkencat Inxhinierike/ Ekonomike/ Juridike
Drejtor Departamenti i Burimeve Njerëzore	Diplomë Universitare MSC në Shkencat Sociale / Ekonomike/ Juridike/ Inxhinierike
Drejtor Departamenti i Shërbimeve	Diplomë Universitare MSC apo MP në Shkencat Inxhinierike/ Ekonomike/ Juridike/
Drejtor Departamenti Elektro - Mekanik	Diplomë Universitare MSC në Shkencat Inxhinierike, preferohet Inxhinieri Elektrike ose Mekanike

Pozicioni i Punës	Arsimi i kërkuar për secilin pozicion pune
Drejtor Departamenti i Veprave Hidro-Teknike	Diplomë Universitare MSC në Shkencat Inxhinierike
Drejtor NjMP me Financim të Huaj	Diplomë Universitare MSC në Shkencat Inxhinierike /Ekonomike/ Juridike
Drejtor Departamenti e Zhvillimit të Burimeve Gjeneruese	Diplomë Universitare MSC në Shkencat Ekonomike ose Inxhinierike
Drejtor Departamenti i Koordinimit të Projekteve të Burimeve Termike	Diplomë Universitare MSC në Shkencat Inxhinierike/ Ekonomike/ Juridike
Drejtor Departamenti TIK dhe Automatizim	Diplomë Universitare MSC apo MP në Shkencat Inxhinierike (Elektronike/Informatike/Telekomunikacion/Teknologji Informacioni etj)
Drejtor të Njërive Prodhuese	Diplomë Universitare MSC në Shkencat Ekonomike ose Juridike ose Inxhinierike
Shef Sektori , Specialist ne Auditin e Brendshëm, Këshilltar ne Kabinet	Arsim i Lartë, Cikli i dytë i studimeve "Master i Shkencave" ose "Master Profesional"
Shef Sektori i Përpunimit të Informacionit (NjKPS)	Diplomë Universitare MSC në Shkencat Inxhinierike/ Ekonomike/ Juridike
Shef Sektori i Aktiviteteve të Terrenit (NjKPS)	Diplomë Universitare MSC në Shkencat Inxhinierike/ Ekonomike/ Juridike
Shef Sektori i Përgjegjësi Social-Mjedisore (DMPT)	Diplomë Universitare MSC apo MP në Shkencat Inxhinierike, Inxhinieri Mjedisori / Shkenca Sociale
Shef Sektori i Komunikimit me Publikun dhe Marrëdhënieve me Jashtë (DMPT)	Diplomë Universitare MSC apo MP në Shkencat Ekonomike /Juridike/Gazetari/ Komunikim
Shef Sektori i Transaksioneve (DTE, DOT)	Diplomë Universitare MSC apo MP në Shkencat Ekonomike, Juridike / Inxhinierike
Shef Sektori i Analizës së Tregjeve (DTE, DOT)	Diplomë Universitare MSC apo MP në Shkencat Ekonomike, Juridike / Inxhinierike
Shef Sektori i Administrimit të Kontratave (DTE, DOT)	Diplomë Universitare MSC apo MP në Shkencat Ekonomike, Juridike / Inxhinieri Elektrike
Shef Sektori i Furnizimit (DTE, DOT)	Diplomë Universitare MSC apo MP në Shkencat Ekonomike, Juridike / Inxhinierike
Shef Sektori i Programimit të Prodhimit (DOP, DOT)	Diplomë Universitare MSC apo MP në Shkencat Inxhinierike / Matematike
Shef Sektori i Analizës dhe Vlerësimit Hidrologjik (DOP, DOT)	Diplomë Universitare MSC apo MP në Shkencat Natyrore (Fizike, Matematike, Informatike) apo Inxhinieri Hidro
Shef Sektori i Dispečerimit (DOP, DOT)	Diplomë Universitare MSC apo MP në Shkencat Inxhinierike, Inxhinieri Elektrike / Mekanike
Shef Sektori i Çështjeve Administrative (DJ, DA)	Diplomë Universitare MSC apo MP në Shkencat Juridike
Shef Sektori i Përfaqësimit Ligjor (DJ, DA)	Diplomë Universitare MSC apo MP në Shkencat Juridike
Shef Sektori i Çështjeve Rregullatore (DJ, DA)	Diplomë Universitare MSC apo MP në Shkencat Juridike/ Ekonomike/Inxhinierike

Pozicioni i Punës	Arsimi i kërkuar për secilin pozicion pune
Shef Sektori i Standarteve Organizative (DJ, DA)	Diplomë Universitare MSC apo MP në Shkencat Ekonomike /Juridike/ Inxhinierike
Shef Sektori i Financës (DE, DA)	Diplomë Universitare MSC apo MP në Shkencat Ekonomike (Profili Financë / Kontabilitet)
Shef Sektori i Kontabilitetit (DE, DA)	Diplomë Universitare MSC apo MP në Shkencat Ekonomike (Profili Financë / Kontabilitet)
Shef Sektori i Planifikimit dhe Raportimit (DE, DA)	Diplomë Universitare MSC në Shkencat Ekonomike /Inxhinierike
Shef Sektori i Administrimit të Aseteve (DE, DA)	Diplomë Universitare MSC apo MP në Shkencat Ekonomike / Inxhinierike
Shef Sektori i Menaxhimit të Riskut (DE, DA)	Diplomë Universitare MSC apo MP në Shkencat Ekonomike/Juridike/Inxhinierike
Shef Sektori i Vlerësimit dhe Analizës (DE, DA)	Diplomë Universitare MSC apo MP në Shkencat Ekonomike / Inxhinierike
Shef Sektori i Politikave të Zhvillimit (DE, DA)	Diplomë Universitare MSC apo MP në Shkencat Ekonomike
Shef Sektori i Planifikimit dhe Ankandeve (DP, DA)	Diplomë Universitare MSC apo MP në Shkencat Juridike / Ekonomike
Shef Sektori i Prokurimeve (DP, DA)	Diplomë Universitare MSC apo MP në Shkencat Inxhinierike, Ekonomike / Juridike
Shef Sektori i Personelit (DBNJ, DA)	Diplomë Universitare MSC apo MP në Shkencat Ekonomike, Juridike / Inxhinierike
Shef Sektori i Karrierës dhe Vlerësimit të Performancës (DBNJ, DA)	Diplomë Universitare MSC apo MP në Shkencat Sociale/Ekonomike/Juridike / Inxhinierike
Shef Sektori i Protokollit dhe Arkivës (DBNJ, DA)	Diplomë Universitare MSC apo MP në Shkencat Sociale,Ekonomike,Juridike / Inxhinierike
Shef Sektori i Shërbimeve të Transportit (DSH, DA)	Diplomë Universitare MSC apo MP
Shef Sektori i Logjistikës (DSH, DA)	Diplomë Universitare MSC apo MP
Shef Sektori i Shërbimeve Mbështetëse (DSH, DA)	Diplomë Universitare MSC apo MP
Shef Sektori i Sigurisë Fizike të Objekteve (DSH, DA)	Arsim i Lartë Policor apo Ushtarak
Shef Sektori i Sistemeve Elektrike (DEM, DT)	Diplomë Universitare MSC apo MP në Shkencat Inxhinierike, Inxhinieri Elektrike
Shef Sektori i Sistemeve Mekanike (DEM, DT)	Diplomë Universitare MSC apo MP në Shkencat Inxhinierike, Inxhinieri Mekanike
Shef Sektori i Monitorimit dhe Sigurisë së Digave (DVHT, DT)	Diplomë Universitare MSC apo MP në Shkencat Inxhinierike (Ndertim/Hidroteknik/ Gjeodezike/Gjeologjike)

Pozicioni i Punës	Arsimi i kërkuar për secilin pozicion pune
Shef Sektori i Mirëmbajtjes së Veprave Hidro- Teknike (DVHT, DT)	Diplomë Universitare MSC apo MP në Shkencat Inxhinierike (Ndertim/Hidroteknike/ Gjeodezike/Gjeologjike)
Shef Sektori i Koordinimit të Njësive të Prodhimit (DT)	Diplomë Universitare MSC apo MP në Shkencat Ekonomike, Juridike / Inxhinierike
Shef Sektori i Projekteve të Reja (DZHBGJ, DT)	Diplomë Universitare MSC apo MP në Shkencat Ekonomike / Inxhinierike
Shef Sektori i Jetësimit të Projekteve (DZHBGJ, DT)	Diplomë Universitare MSC apo MP në Shkencat Ekonomike / Inxhinierike
Shef Sektori i Administrimit të Kontratave (DKPBT, DT)	Diplomë Universitare MSC në Shkencat Inxhinierike / Ekonomike / Juridike
Shef Sektori i Mbështetjes Teknike (DKPBT, DT)	Diplomë Universitare MSC në Shkencat Inxhinierike / Ekonomike / Juridike
Shef Sektori i Zhvillimit të Sistemeve (DTA, DT)	Diplomë Universitare MSC apo MP në Shkencat Informatike/Inxhinierike, Elektronike
Shef Sektori i Mirëmbajtjes së Sistemeve (DTA, DT)	Diplomë Universitare MSC apo MP në Shkencat Informatike/ Inxhinierike, Elektronike
Shef Sektori i Sigurisë Kibernetike (DTA, DT)	Diplomë Universitare MSC apo MP në Shkencat Informatike/ Inxhinierike/ Elektronike
Specialist në Auditin e Brëndshëm	Diplomë Universitare MSC / Sipas parashikimeve të ligjit për Auditin e Brëndshëm në sektorin publik
Këshilltar në Kabinet	Arsim i Lartë ,Cikël i dytë i studimeve "Master i Shkencave" / "Master Profesional"
Specialist i Nivelit të Parë	Të njëjtat kritere Arsimimi të Eprorit të Drejtpërdrejt "Master i Shkencave" / "Master Profesional"
Specialist i Nivelit të Dytë	Të njëjtat kritere Arsimimi të Eprorit të Drejtpërdrejt "Master i Shkencave" / "Master Profesional"
Specialist i Nivelit të Tretë	Diplomë e Arsimit të Lartë "Master i Shkencave" / "Master Profesional"
Specialist i Nivelit të Katërt /Asistente Administratori/ Asistente Zv. Administratori	Diplomë e Arsimit të Lartë "Bachelor"
Punonjës me Arsim të Mesëm në Aparatin Qëndror	Arsim i Mesëm
Shofer i Administratorit	Arsim i Mesëm i Përgjithshëm / Profesional, leja e drejtimit për mjetin përkatës
Asistente /Sherbime Sekretarie, Magazinier, Specialist Mirëmbajtje	Arsim i Mesëm i Përgjithshëm / Profesional
Punonjes Receptioni	Arsim i Mesëm i Përgjithshëm / Profesional
Shofer	Arsim i Mesëm i Përgjithshëm / Profesional, leja e drejtimit për mjetin përkatës
Punonjes Mirëmbajtje, Punonjes Sanitare	Arsim i Mesëm i Përgjithshëm / Profesional,

Lidhja nr. V

Tabela e Kriteve/ Kualifikimeve Arsimore për Pozicionet e Punës në Njësitë Prodhuese

Pozicioni i Punës	Arsimi i kërkuar për secilin pozicion pune
Arsimi i Lartë, Cikël i dytë i studimeve "Master i Shkencave"	
Drejtor te Njesive Prodhuese	Diplomë Universitare në Shkencat Ekonomike / Juridike / Inxhinierike
Sektori i Sherbimeve dhe Personelit	Arsimi i Lartë, Cikël i dytë i studimeve "Master i Shkencave" / "Master Profesional"
Shef Sektori	Diplomë Universitare në Shkencat Ekonomike / Juridike / Inxhinierike
Arsimi i Lartë, Cikël i dytë i studimeve "Master i Shkencave", "Master Profesional"/ Cikël i parë i studimeve "Bachelor"	
Jurist	Diplomë Unlversitare në Shkencat Juridike
Specialist Personeli	Diplomë Universitare në Shkencat Sociale / Ekonomike / Juridike / Inxhinierike
Specialist Sherbimesh	Diptome Universitare në Shkencat Ekonomike / Juridike / Inxhinierike
Specialist IT	Diplomë Universitare në Shkencat Informatike / Inxhinierike - Elektronike / Automatizim
Arsimi i Lartë, Cikël i parë i studimeve "Bachelor"/ Arsim i Mesëm	
Asistente/Sekretari	Diplomë Universitare në Shkenca Shoqerore, Ekonomike, Juridike / Inxhinierike/ Arsim i Mesëm
Protokollist-Arkivist	Diplomë Universitare në Shkenca Shoqerore, Ekonomike, Juridike / Inxhinierike/ Arsim i Mesëm
Shofer Titullari	Arsimi i Mesëm i Përgjithshëm / Profesional, leja e drejtimit për mjetin përkatës
Shofer	Arsimi i Mesëm i Përgjithshëm / Profesional, leja e drejtimit për mjetin përkatës
Drejtues per Mjete Teknologjike	Arsimi i Mesëm i Përgjithshëm / Profesional, leja e drejtimit për mjetin përkatës
Punonjes Sanitare	Arsimi i Mesëm i Përgjithshëm / Profesional/ Arsimi i Detyrueshëm
Sektori Ekonomik	Arsimi i Lartë, Cikël i dytë i studimeve "Master i Shkencave" / "Master Profesional"
Shef Sektori	Diplomë Universitare në Shkencat Ekonomike (preferohet profili Financë apo Kontabilitet)
Arsimi i Lartë, Cikël i dytë i studimeve "Master i Shkencave", "Master Profesional"/ Cikël i parë i studimeve "Bachelor"/ Asim i Mesëm	
Financier	Diplomë Universitare në Shkencat Ekonomike / Juridike / Inxhinierike
Ekonomist	Diplomë Universitare në Shkencat Juridike
Magaznier	Arsimi i Mesëm i Përgjithshëm / Profesional
Sektori Teknik	Arsimi i Lartë, Cikël i dytë i studimeve "Master i Shkencave" / "Master Profesional"

Lidhja nr. V

Tabela e Kritereve/ Kualifikimeve Arsimore për Pozicionet e Punës në Njësitë Prodhuese

Pozicioni i Punës	Arsimi i kërkuar për secilin pozicion pune
Arsimi i Lartë, Cikël i dytë i studimeve "Master i Shkencave"	
Shef Sektori	Diplomë Universitare në Shkencat Inxhinerike, Inxhinieri Elektrike / Mekanike
Arsimi i Lartë, Cikël i dytë i studimeve "Master i Shkencave", "Master Profesional"/ Cikël i parë i studimeve "Bachelor"/ Asimi i Mesëm	
Specialist i Sigurimit Teknik, MKZ dhe Shendetit ne Pune	Diplomë Universitare në Shkencat Inxhinerike, Inxhinieri Elektrike / Mekanike
Specialist Planifikimi	Diplomë Universitare në Shkencat Inxhinerike / Ekonomike
Asistent teknik	Arsimi i Mesëm i Përgjithshëm / Profesional (preferohet Elektrike / Mekanike)
Sektori i Mirembajtjes	Arsimi i Lartë, Cikël i dytë i studimeve "Master i Shkencave" / "Master Profesional"
Shef Sektori	Diplomë Universitare në Shkencat Inxhinerike, Inxhinieri Elektrike / Mekanike
Reparti Elektrik	Arsimi i Lartë, Cikël i dytë i studimeve "Master iShkencave", "Master Profesional"/ Cikël i parë i studimeve "Bachelor"/ Asimi i Mesëm
Pergjegjes Reparti	Diplomë Universitare në Shkencat Inxhinerike, Inxhinieri Elektrike
Inxhinier Primar	Diplomë Universitare në Shkencat Inxhinerike, Inxhinieri Elektrike
Inxhinier Mbrojtje Rele dhe Komandimit	Diplomë Universitare në Shkencat Inxhinerike, Inxhinieri Elektrike
Inxhinier i Automatikes dhe Rregullimit	Diplomë Universitare në Shkencat Inxhinerike, Inxhinieri Elektrike
Inxhinier i Kontrollit dhe Monitorimit	Diplomë Universitare në Shkencat Inxhinerike, Inxhinieri Elektrike
Pergjegjes Grupi	Arsim i Mesëm Profesional Elektrike
Remontier Primar	Arsim i Mesëm Profesional Elektrike
Remontier Sekondar	Arsim i Mesëm Profesional Elektrike
Baterist	Arsim i Mesëm Profesional Elektrike
Atrcier	Arsim i Mesëm Profesional Elektrike
Reparti Mekanik	Arsimi i Lartë, Cikël i dytë i studimeve "Master i Shkencave", "Master Profesional"/ Cikël i parë i studimeve "Bachelor "/ Asimi i Mesëm
Pergjegjes Reparti	Diplomë Universitare ne Shkencat Inxhinierike, Inxhinieri Mekanike
Inxhinier Remonti	Diplomë Universitare ne Shkencat Inxhinierike, Inxhinieri Mekanike
Pergjegjes Grupi	Arsim i Mesëm Profesional Mekanike
Atrcier	Arsim i Mesëm Profesional Mekanike
Remontier	Arsim i Mesëm Profesional Mekanike
Saldator	Arsimi i Mesëm i Përgjithshëm / Profesional

Lidhja nr. V

Tabela e Kriteve/ Kualifikimeve Arsimore për Pozicionet e Punës në Njësitë Prodhuese

Pozicioni i Punës	Arsimi i kërkuar për secilin pozicion pune
Arsimi i Lartë, Cikël i dytë i studimeve "Master i Shkencave"	
Reparti Hidroteknik	Arsimi i Lartë, Cikël i dytë i studimeve "Master i Shkencave", "Master Profesional"/ Cikël i parë i studimeve "Bachelor"/ Asim i Mesëm
Pergjegjes Reparti	Diptome Unlversitare ne Shkencat Inxhinierike, profili Hidroteknikë / Ndërtim
Specialist mirembajtje per pune Civile	Diptome Universitare ne Shkencat Inxhinierike, profili Hidroteknikë / Ndërtim
Pergjegjes Grupi	Arsim i Mesëm, Ndërtim
Asistent Teknik	Arsim i Mesëm (preferohet teknik ndërtimi)
Pizometrist	Arsim i Mesëm (preferohet teknik ndërtimi)
Polumbar (vetem HEC Vau Dejes)	Arsim i Mesëm
Punetor	Arsim i Mesëm
Sektori i Shfrytezimit (Pese Turnet A/B/C/D / E)	Arsimi i Lartë, Cikël i dytë i studimeve "Master i Shkencave" / "Master Profesional"
Shef Sektori	Diplomë Universitare në Shkencat Inxhinierike, Inxhinieri Elektrike / Mekanike
Arsimi i Lartë, Cikël i dytë i studimeve "Master i Shkencave", "Master Profesional"/ Cikël i parë i studimeve "Bachelor"/ Asimi i Mesëm	
Disper Rajonal	Diplomë Universitare në Shkencat Inxhinierike, Inxhinieri Elektrike
Arsim i Mesëm, Elektrike, Mekanik	
Elektriçist Ndhmës	Arsim i Mesëm Profesional Elektrike
Turbunist Kryesor	Arsim i Mesëm Profesional Mekanike
Turbunist	Arsim i Mesëm Profesional Mekanike
Turbunist Ndhmes	Arsim i Mesëm Profesional Mekanike
Pompist Kompresorist	Arsim i Mesëm Profesional Mekanike / Elektrike
Dr/ list	Arsim i Mesëm Profesional Mekanike / Elektrike
Pompist Galeria Diges	Arsim i Mesëm Profesional Mekanike / Elektrike